



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONIERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 8.3.2023

Nr: 108

Ora: 11:00

**VENDIM**

**PËR**

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “PARTIA ORA E SHQIPËRISË” PËR REGJISTRIMIN SI  
SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ  
2023**

Sot më datë, 8.3.2023 në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 671 Prot., datë 7.2.2023, me:

**Kërkues:** Partia politike “Partia Ora e Shqipërisë”, me kryetar z. Zef Shtjefni

**Objekti:** Regjistrimi i partisë politike “Partia Ora e Shqipërisë” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

**Baza ligjore** Neni 64 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

**V Ë R E J:**

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

“Partia Ora e Shqipërisë”, nëpërmjet kryetarit të saj z. Zef Shtjefni, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj 2023, administruar.

Data: 8.3.2023 Nr: 108  
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Ora e Shqipërisë”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 30.01.2023, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia Ora e Shqipërisë” me initiale “POSH”, me Kryetar z. Zef Shtjefni rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike, (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia Ora e Shqipërisë” me shkronja nistore “POSH”, me adresë Rruga “Ifiran Tomini NISHIRAK”, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Zef Shtjefni, me adresë Rruga “Sali Butka”, H nr.2, Kt i 5, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është z. Tajar Latifi me adresë Njësia Ad Nr. 8, Rruga “Pal Hasi”, Banesë private, Nr. 24 Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është z. Qamil Hoxha, me adresë, Pall Nr 4, pranë Shkollës së Bashkuar Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia Ora e Shqipërisë”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues kërkesës, i paraqitur nga “Partia Ora e Shqipërisë” është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, nenin 64, pika 2 dhe nenin 92 /2 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të udhëzimit nr. 1, datë 18.1.2023, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”

#### **VENDOSA:**

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia Ora e Shqipërisë”, me kryetar z. Zef Shtjefni, me shkronjat nistore “POSH”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

